

## KONTRTË DHURIM KUOTASH



Në Tiranë, sot, më date 25/11/2020.

**DHURUESI:** Z. ARBËR KACI, me atësi Ali dhe amësi Behare, i datëlindjes 09/05/1989, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me numër personal I905090670. Shtetas Shqipëtar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me cilësinë e zotëruesit të 50% të kapitalit të Shoqërisë "OPTIMEDIA" sh.p.k. me NUIS L82118023Q, themeluar në datën 12/09/2018, regjistruar pranë QKB më datë 18/09/2020, me seli në Tiranë, Rruga "Aleksander Moisiu", Nr.76/1 (prane Ora News).

Dhe

**PËRFITUESI:** Z. REDON NDROQI, me atësi YLLI dhe amësi Mimoza, i datëlindjes 13/06/1990, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me numër personal J00613062M. Shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, zotëruesit të 50% të kapitalit të Shoqërisë "OPTIMEDIA" sh.p.k. me NUIS L82118023Q, themeluar në datën 12/09/2018, regjistruar pranë QKB më datë 18/09/2020, me seli në Tiranë, Rruga "Aleksander Moisiu", Nr.76/1 (prane Ora News).

### Kushtet paraprake që ekzistojnë

1. Rezulton se shoqëria "OPTIMEDIA" sh.p.k. është person juridik shqipëtar regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 18/0/2018 dhe pajisur me numër identifikimi NUIS – L82118023Q, me kapital themeltar 1.000 (njëmijë) lekë.
2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Ushtrimi i aktivitetit në fushën e agjensisë publicitare, shërbimeve të marketingut dhe konsulences.
3. Ortakët e Shoqërisë janë Z. Arbër Kaci i cili zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë me vlerë totale 500 (pesëqind) lekë dhe Z. Redon Ndroqi i cili zotëron 50% të kapitalit me vlerë 500 (pesëqind) lekë.
4. Ortaku i Shoqërisë "OPTIMEDIA" sh.p.k. Z. Arbër Kaci ka vendosur të dhurojë kuotën e vet prej 50 % (pesëdhjetë) të kapitalit të Shoqërisë që ai zotëron, në vlerën 500,00 (pesëqind) lekë në favor të Z. Redon Ndroqi.



**Neni 1**  
**Objekti i Kontratës**

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është dhurimi i 50% (pesëdhjetë) të kapitalit të Shoqërisë, të zotëruar nga Z. Arbër Kaci me vlerë 500,00 lekë (ALL).

**Neni 2**  
**Çmimi i shitjes**

2.1 Palët, bien dakort që kuota prej 50% (pesëdhjetë) të kapitalit të shoqërisë do të dhurohet.

**Neni 3**  
**Kalimi i titullit të pronësisë**

3.1 Kalimi i titullit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 3.2 të këtij neni.

3.2 Shoqëria regjistron kalimin e kuotes, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

3.3 Një kopje e kësaj kontrate dhurimi do të depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, (QKB) në mënyrë që të pasqyrohet kalimi i menjëhershëm i kuotave në pronësi të blerësit.

**Neni 4**  
**Të drejtat dhe detyrimet e dhuruesit**

4.1 Dhuruesi më për sipër, të njoftojë, garantojë dhe sigurojë Përfituesin se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të kësaj Kontrate, keto kuota:

- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor
- Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve.
- Dhuruesi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
- Dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj Kontrate, është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i fallsifikuar.
- Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota.



- Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve .

4.2 Dhuruesi është i detyruar të paguajë detyrimet në Shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga përfituesi në përpjestim me kuotat. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve të Kodit Civil.

## Neni 5

### Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit

5.1 Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Përfituesi do paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në Shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit etj ...

5.2 Përfituesi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

5.3 Përfituesi angazhohet të mbajë në emrin e vet kuotat që do të përfitojë nga kjo kontratë shitjeje kuotash.

5.4 Përfituesi pranon pa kushte se nuk do të shesë, lejë peng apo çdo formë tjetër tjetërsimi të kuotave, pa miratimin e zotëruesve të të paktën 1/2 (një të dytat) e kuotave të Shoqërisë.

5.5 Në rast miratimi të shitjes së kuotave, ato do ju ofrohen si fillim ortakëve të tjerë të shoqërisë dhe vetëm në rast refuzimi nga ana e tyre, kuotat do ju ofrohen për shitje palëve të treta.

5.6 Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë, të palëve.

## Neni 6

### Zgjidhja e kontratës

6.1 Palët nuk mund ta zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

6.2 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontrates i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të realizojnë ndryshime në kontratë.



**Neni 7.**  
**Interpretimi i Kontratës në tërësi**

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

**Neni 8**  
**Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni**

8.1 Kjo Kontratë shitje, më objekt Shitje kuotash, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008" Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligji 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 9**  
**Njoftimet**

9.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkuara në këtë Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

**Neni 10**  
**Gjuha e kontratës**

10.1 Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

**DHURUESI**  
**Arbër KACI**



**PËRFITUESI**  
**Redon NDROQI**

